



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 janar 2013  
Nr. ref.:RK 369/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI106/12**

Parashtrues

**Lulzim Ramaj**

**Kërkesë për njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Kërkesa**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lulzim Ramaj, me vendbanim në Pejë (parashtruesi i kërkesës).
2. Më 3 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën e parë (Rasti Nr. KI32/11) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata). Rasti ishte refuzuar si i papranueshëm, më 18 janar 2012.

### **Objekti i çështjes**

3. Kërkesa e tanishme është vazhdim i rastit Nr. KI32/11. Parashtruesi tash ankohet se organizata e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) po "refuzon lëshimin e vërtetimit të pjesëtarit të UÇK-së dhe mohon njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së, publikimi i rastit në media dhe shpifjet nga OVL e UÇK-së [...]".
4. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon se "[...] kjo bie ndesh me nenin 21, paragrafi 1, nenin 24, paragrafi 1, nenin 36, paragrafi 1 dhe nenin 41, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin a dhe nenin 29, paragrafi 2, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 2, paragrafi 1 (a) dhe (b), nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin a, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1, nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe nenin 1 (Detyrimi për t'i zbatuar të drejtat e njeriut) dhe Nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj".
5. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të mos e zbulojë identitetin e tij, pa ofruar arsye të mëtejme.

### **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatë**

7. Më 18 janar 2012, Gjykata Kushtetuese, në një rast të mëparshëm (Rasti Nr. KI32/11), e shpalli kërkesën të papranueshme në bazë të asaj se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte ende në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme. Prandaj, kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme. Ai përfundim ishte në përputhje me informatat e dhëna parashtruesit të kërkesës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës se "parashtresa e tij në lidhje me zvarritjen e shqyrtimit nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk i plotëson kriteret për t'u trajtuar si zvarritje nga Gjykata". Parashtresa është ende në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme.
8. Më 22 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi një kërkesë të re në Gjykatë.
9. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 29 janar 2013 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

11. Asnjë informatë e re në përkitazi me rastin e mëparshëm KI32/11 nuk është dorëzuar në Gjykatë.
12. Faktet, siç janë përshkruar në Rastin KI32/11, ishin si vijon:
13. Më 17 shtator 2010, parashtruesi e dorëzoi një kërkesë në organizatën e veteranëve, OVL e UÇK-së, Dega në Pejë, për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së dhe, gjithashtu, kërkoi t'i lëshohet "Libreza e UÇK-së".

14. Më 12 tetor 2010, për shkak të heshtjes administrative nga Dega e Pejës, sipas nenit 131 të Ligjit për Procedurën Administrative në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-28), parashtruesi ushtroi një ankesë në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë.
15. Më 13 dhjetor 2010, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, për shkak të faktit se ai nuk e kishte marrë vendimin për ankesën e tij të ushtruar në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së.
16. Më 28 dhjetor 2010 dhe më 29 janar 2011, parashtruesi dorëzoi ankesa në Inspektoratin Gjyqësor të Kosovës kundër mosveprimit të Gjykatës Supreme.
17. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi mori një letër nga Zyra e Avokatit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilën u informua se parashtruesi e tij përkitazi me zvarritjen e shqyrtimit nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk e kishte plotësuar kriterin kohor për t'u marrë në konsideratë.
18. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi një kërkesë tjetër në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar shqyrtimin e ankesave të tij, të 28 dhjetorit 2010 dhe të 29 janarit 2011.
19. Faktet në Rastin KI106/12 janë paraqitur si në vijim:
20. Më 1 mars 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Organizatës Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë, pa përmendur se në cilën organizatë ishte ankuar.
21. Më 23 mars 2011, parashtruesi i kërkesës e ndryshoi ankesën e tij dhe, në vend se të kërkojë njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, ai kërkoi të ketë statusin e pjesëtarit të UÇK-së.
22. Më 4 korrik 2012, parashtruesi kishte paraqitur një parashtrësë në Gjykatën Supreme, për të cilën, sipas parashtruesit, nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Parashtruesi nuk ka treguar se çfarë parashtrësë kishte paraqitur dhe për çfarë.
23. Më 18 korrik 2012, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër Gjykatës Supreme, për shkak të mosshqyrtimit dhe të moszgjidhjes së rastit të tij.
24. Më 24 gusht 2012, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative dhe për refuzimin e ankesës së tij të 18 korrikut 2012. Sipas parashtruesit, ai ende nuk ka marrë asnjë përgjigje.
25. Për më tepër, asnjë dokumentacionin mbështetës dhe asnjë informatë nuk është ofruar sa i përket arsyeve të parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

26. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për ankesën e re të parashtruesit të kërkesës, është e nevojshme që në fillim të vlerësohet se a i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar me tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (e), i cili thekson: *“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”*.

28. Ankesa e parashtruesit të kërkesës se atij i është refuzuar njohja e statusit të pjesëtarit të UÇK-së, tashmë ishte refuzuar nga Gjykata me Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI32/11.
29. Parashtruesi ka dështuar të ofrojë baza të reja dhe të mjaftueshme për një vendim të ri. Informata e vetme e re që ka ofruar parashtruesi i kërkesës në Gjykatë është se ai dëshiron ta ndryshojë kërkesën e tij nga njohja e statusit të veteranit të UÇK-së në status të pjesëtarit të UÇK-së. Për më tepër, parashtruesi nuk kishte ofruar në Gjykatë aktin final të lëshuar nga autoriteti publik që ai e konteston në Gjykatë. Për më tepër, procedura, të cilën e kishte ndërmarrë parashtruesi pas Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin KI32/11, kishte të bënte gjithashtu me atë se parashtruesi, në vend se të kërkojë statusin e veteranit të UÇK-së, tani kërkon njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së.
30. Prandaj, sipas rregullit 36(3) (e) të Rregullores, Gjykata nuk do të merret me këtë kërkesë.
31. Në këto rrethana, Gjykata konkludon, në bazë të rregullit 36 (3. e) të Rregullores së punës, se kërkesa është e papranueshme, pasi Gjykata tashmë ka vendosur për çështjen në fjalë.
32. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij, parashtruesi nuk kishte ofruar bazë mbështetëse dhe as prova për ta mbështetur kërkesën e tij për moszbulimin e identitetit. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e tillë si të pabazuar.

#### PER KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36 (3. e) dhe të rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 29 janar 2013, njëzëri

#### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme, pasi Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit të kërkesës në Rastin Nr. KI32/11, që do të thotë rasti është *res judicata*;
- II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani